

Data 28.10.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**Rivitalizimi i hapësirave rreth pallatit të sportit “ Luftëtari ”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Punë ndërtimi 45100000-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

18.409.060 ( tetëmbëdhjetë milion e katërqind e nëntë mijë e gjashtëdhjetë) **Lek, pa TVSH**

<b>Viti</b>	<b>Buxheti i shtetit</b>
<b>2024</b>	<b>10.765.639</b>
<b>2025</b>	<b>7.643.421</b>

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gjirokastrë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës ....
- c. Formular oferte

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Neni 55 pika 4 paragrafi II

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

---

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare, 2021-2022-2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, te ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41,

pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 dhe kestin perkates te maturuar per vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar) për të gjitha adresat ku operatorët ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas të dhënave të ekstraktit të QKB- së historik.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

#### **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :**

1. Kontrate sipermarrjeje ;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore per situacionin përfundimtar
5. Certifikatë e marrjes në dorëzim e perkohshme ose përfundmtare

#### **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten**

1. Kontrate sipermarrjeje ;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore per situacionin përfundimtar

***Pika 2.3.1 a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesmarrjes së tyre në bashkim.***

***Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet edhe kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

**2.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e Vkm nr 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit , klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :**

**N.P – 1      A      Punime gjurmimi në tokë.**  
**N.P – 2      A      Ndërtime civile dhe industriale**  
**N.P – 4      A      Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.**

**Për punimet speciale të ndërtimit :**

**N.S – 6      A      Sinjalistika rrugore jondriçuese.**

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI
		<b>1. Punime ne trupin e rruges</b>			
1	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	12	Np 2
2	3.87/b	Germim dheu me ekskavator goma, 0.25 m <sup>3</sup> , (Germim i shtreses se binderit dhe te stabilizantit, t=30 cm).	m3	579	Np1
3	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km (Materiali i germuar)	m3	579	Np 2
4	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	1970	Np 4
5	3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	1970	Np 4
6	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri	m2	1930	Np 4
7	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	1930	Np 4
8	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25 (Kuneta)	m3	8.5	Np 2
		<b>Shuma 1</b>			
		<b>2.Punime KUB</b>			

1	3.87/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	444	Np1
2	3.45/1	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m <sup>2</sup>	m3	14	Np1
3	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km (Materiali i germuar)	m3	458	Np 2
4	3.706	Mbushje me zhavorr ne trupin e rruges, (mbushja e kanaleve)perhapur me makineri (me ngjeshje cdo 20 cm)	m3	332	Np 4
5	3.379	Ndertim drenazhi,mbushje me rere natyrale (Nden dhe mbi tubat e brinjezuar)	m3	25	Np 4
6	3.164/1t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	78	Np 4
7	3.164/2t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm	ml	23	Np 4
8	3.365	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni	ml	191	Np 4
9	2.262/3	Shtrese betoni C12/15 t=10cm	m3	15	Np 2
10	3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm	m2	134	Np 4
11	2.595	F.V. pusete 40x60x150 cm, me kapak zgare gize	cope	19	Np 2
12	2.599	F.V. pusete shkarkimi 100x100, h=200, me kapak gize	cope	9	Np 2
13	2.182	F V konstruksione metalike te thjeshta (Pllake metalike per mbulimin e kanalit)	ton	4.3	Np 2
14	2.401	Boje vaji siperfaqe metalik	m2	33	Np 2
15	2.599	F.V. pusete shkarkimi 100x100, h=200, me kapak gize( per KUZ )	cope	2	Np 2
<b>3. Punime per sinjalistiken</b>					
1	3.942	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente ( sprajt)	ml	774	Ns 6
2	3.946/1	Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Bikomponente (paste) (Vijezimet diagonale)	m2	93	Ns 6
3	3.955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	cope	5	Ns 6
4	3.953	FV tabela rrugore treguese 150x40cm	cope	1	Ns 6
<b>4.Punime në trotuar rruge dhe shkallë</b>					
1	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	40	Np 4
2	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	40	Np 4
3	2.261	Shtrese rere (nen dhe mbi tubacione + kompaktesim), t=6 cm	m3	20	Np 4
4	2.288	Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit ( Pllaka vetshtrenguese t = 6 cm )	m2	40	Np 4
5	3.616/b	F V bordura betoni 15x30cm	m	62	Np 4

6	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20(Fiksim bordure)	m3	5	Np 2
7	3.639	Veshje me pllaka guri (Gur i zi, t=5 cm per shkallët dhe sheshpushimet)	m2	150	Np 2
		<b>5. Punime elektrike</b>			
1	3.167	FV shtylla metalike konike ndricimi H=9 m PAICC-3	cope	13	Np 2
2	3.168	FV krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	cope	16	Np 2
3	2.463	F.V. Ndricules projektor me llampe SAP-T 250w	cope	16	Np 2
4	3.172	F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement	cope	1	Np 2
5	An.1	Tub korrogat Ø 63 mm, outdoor, me izolim të dyfishtë	m	325	Np 2
6	3.176	FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086	cope	17	Np 2
7	An.2	F.V. morseteri shtylle 3P=sig.16A+kapak	cope	16	Np 2
8	3.182	FV elektroda tokezimi te xinguar 50x3mm L=150cm	cope	13	Np 2
9	2.481/2	F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	300	Np 2
10	An.3	F.v Percjelles toke (verdhe/jeshil) 1x16mm2 FG7OR	ml	15	Np 2
11	An.4	Kabell 4x4mm <sup>2</sup> FG7OR	ml	325	Np 2
12	2.503	F.V. Percjelles shirit Zn 30x3mm	ml	325	Np 2
13	2.490/1a	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A	cope	15	Np 2
14	2.476	F.V Tuba PVC Ø 250 mm per linja te jashtme (per vendosjen e shtyllave)	m	15	Np 2
15	3.407	F.V. Tuba metalik D=140 mm (per intersektimet)	m	31	Np 2
16	2.261	Shtrese rere (nen dhe mbi tubacione + kompaktesim)	m3	20	Np 2
17	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (Plint betoni per fiksim te shtylles 90x90x100cm	m3	10.65	Np 2
18	3.87/b	Germim dheu per bazamentin e shtyllave dhe pusetat	m3	10	Np1
19	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	10	Np 2

**2.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- |                 |           |
|-----------------|-----------|
| a) Ing ndërtimi | 1 ( një ) |
| b) Ing elektrik | 1 ( një ) |

Secili prej pjesëtarëve të drejtuesve teknik të mësipërm duhet të jetë në listëpagesat e muajit Korrik 2024- Shtator 2024 si dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë.

Për secilin prej tyre duhet të paraqitet :

- Kontratë pune e vlefshme
- Diploma
- CV

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

**2.6** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Korrik 2024- Shtator 2024

- |                        |   |
|------------------------|---|
| • Teknik ndertimi      | 1 |
| • Betonist             | 4 |
| • Pllakashtrues        | 4 |
| • Elektracist          | 1 |
| • Saldator             | 2 |
| • Punetore te thjeshte | 5 |



Punonjësit e mësipërm të jenë të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose ekuivalente me to të akredituara nga legjislacioni në fuqi si dhe të paraqitet kontratë pune e vlefshme.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

. Gjithashtu OE, duhet të plotësojnë tabelën në vijim:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

**Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”; nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Korrik 2024- Shtator 2024, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo deshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu

*është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Analizat teknike janë bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre ” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te kostos.*

**2.7** Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë te stafit :

- Shofer 5
- Manovrator 7

Për punonjësit e mësipërm të paraqiten dëshmi aftësie profesionale , leje drejtimi për shoferët si dhe kontratë pune e vlefshme ose të figurojnë në listëpagesat e muajit Korrik 2024- Shtator 2024 kjo në varësi të mjeteve që disponojnë në pronësi ose me qera.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikëduhet të vetëdeklarojnëdisponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

**Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Korrik 2024- Shtator 2024, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë

*kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Analizat teknike janë bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te kostos.*

**2.8** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojëfuqi punëtore prej **minimalisht 31 persona** të cilët duhet të jenë pjesë e listëpagesave të muajit Korrik 2024- Shtator 2024

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikëduhet të vetëdeklarojnëdisponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

**Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 39 pika 6/ Ç

*Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Korrik 2024- Shtator 2024, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e*

kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për njëpunësim te paktën 12 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*Analizat teknike janë bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre ” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar ne kater elementet e struktures se koston(material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te koston.*

**2.9** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (nje) Punonjes i pajisur me Certifikatë trajnimi për “ Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë ” i dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj
- 1 (nje) Punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin*

*Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.9 duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2024- Shtator 2024. Ndërsa punonjësit e kualifikuar si (Manovrator), të cilët përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jenë të kontraktuar vetëm në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qira*

**Argumentimi :** Kërkesa e shkronjës e) të pikës 2.3.6, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010, "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-së nr. 312/2010, është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

**2.10** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Eskavator me goma 05 -2 m3	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Betonier	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Rul me vibrim	Copë	1	Në pronësi ose me qira

6	Autobetoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Rul ngjeshes me kompresor per shtresat asfaltike	Copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Rul me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Makineri sperkates boje per vizime ne rruge	Copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Autobot primer	Copë	1	Në pronësi ose me qira
11	Tokmak	Copë	1	Në pronësi ose me qira
12	Vibrator betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira
13	Asfalto shtruese	Copë	1	Në pronësi ose me qira
14	Autobitumatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qira
15	Greider	Copë	1	Në pronësi ose me qira
16	Makineri gwrryese e shtresave (bobcat)	Copë	1	Në pronësi ose me qira
17	Matrapik	Copë	1	Në pronësi ose me qira
18	Motogjenerator	Copë	1	Në pronësi ose me qira
19	Rimorkio mbi 20 ton per transportin e mjeteve te renda	Copë	1	Në pronësi ose me qira
20	Kontenier – Zyre levizese	Copë	1	Në pronësi ose me qira
21	Saldatrice elektrike	Copë	1	Në pronësi ose me qira

- Kokore minimumi 31 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksen vjetore dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën përkatëse të qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) **Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave(te vlefshme),leshuar nga organet kopetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit ,ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.**
- f) **Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë ne çdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknik**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

#### **Argumentimi:**

*Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

*Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).*

**2.11** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht:

a) **ISO 14001:2015** Sistemet e menaxhimit te ambientit / **ekuivalente dhe e vlefshme**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 1, nenit 45, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 79 të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” është tepër e rëndësishme që operatorët ekonomik ofertues si zbatues të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të mjedisit, të cilët janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe certifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Ky certifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky certifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor.

b) **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, **ekuivalente dhe e vlefshme**

**Argumentimi :** **ISO 9001:2015** ose ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë “ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Në bazë të pikës 1, nenit 45, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate.

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është **standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel nderkombëtar**. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme

c) **OHSAS 45001:2018**, mbi “Sistemin e Menaxhimit te Shëndetit dhe sigurise në punë”, **ekuivalente dhe e vlefshme**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 1, nenit 45, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar dhe të vërtetojnë cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, sipas objektit të kësaj kontrate. Kjo certifikatë përfaqëson pikën e referimit,



*e njohur në nivel botëror, për certifikimin e cilesise së menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë të cilësisë së bizneseve të gjithë sektorëve dhe të gjitha përmasave.*

*Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve. Kjo çertifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi, kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve.*

d) - **BS ISO 39001:2012** Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor.

- *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

**Argumentimi:**

*Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

**2.12** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve urbane), së bashku me aktin e miratimit nr 5

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në*

*nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.*

*Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.*

*Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.*

*Ndërkohë, sipas VKM Nr.538, datë 26.5.2009. “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.*

*Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

*Ne preventivin e punimeve janë parashikuar punime prishje, ku krijohen mbetje të ndryshme, për transportin e të cilave nevojitet dhe është e domosdoshme disponimi i licences të kërkuar në këto kriter kualifikimi*

**2.13** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera, si dhe të deklarojë se pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

**2.14** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deshmon se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fituese.

**2.15** Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga ana e Administratorit të shoqërisë Drejtuesin teknik të punimeve në kantier ose Përgjegjës teknik të kantierit I cili duhet të jetë resident dhe me kohë të plotë në kantier dhe jo I angazhuar në kontrata të tjera I cili duhet të jetë diplomuar në inxhinieri ndërtimi (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë)

**2.16** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëdeklarim, sipas deklaratës në vijim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave nga operatori ekonomik, që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit

**2.17** Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkepunimi impiantet si më poshtë vijon:

- a. 1 (nje) Impiant prodhimi Inerte
- b. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni
- c. 1 (nje) Fabrike Asfaltbetoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/ betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vertetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/ betonit, është me qera ose kontratë bashkepunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave/bashkëpunimit.

**PIKA 2.17 do të plotësohet duke paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik dokumentacionin e sipercituar në fazën e ofertimit të ofertës dhe jo vetëm duke cituar numrin e kontratës në Formularin e Vetdeklarimit Shtojca 8**

AK do të bëjë verifikimet e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht për skualifikim.

### Sqarim

AK për të bërë sa më të thjeshtë procesin e verifikimit të gjendjes gjyqësore për anëtarët e organit administrativ, drejtuesit ose mbikqyrësit aksionerit ose ortakut ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik këkon nga ana e operatorëve ekonomik për të deklaruar ID e personave të cilët do të deklarohen në Shtojcën 9 të Formularit Përmbledhës i Vetëdeklarimit për këtë verifikim.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

***NJËSIA E PROKURIMIT***